



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
SENATI AKADEMIK DHE BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 616/5 Prot.

Tiranë, më 21.02.2020

**VENDIM I PËRBASHKËT**

Nr. 20, datë 21.02.2020

**PËR LLOGARITJEN E NOTËS MESATARE PËR STUDENTËT E CIKLIT TË PARË DHE TË INTEGRUAR TË CIKLIT TË DYTË, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, PËR EFEKT TË TARIFËS VJETORE**

Në bazë të pikës “k” të nenit 38, nenit 49, të ligjit nr.80/2015, ”Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr.778, datë 26.12.2018 “Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.288, datë 21.05.2018, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kufirit maksimal, të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”, pika “d”, e nenit 6 të Statutit të UMT-së, si dhe në shkresën nr.1036 prot datë 06.02.2020 “Mbi zbatimin e VKM-së nr.778, datë 26.12.2018” të Ministri përgjegjës për arsimin, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit në mbledhjen e përbashkët të datës 21.02.2020,

**VENDOSI:**

1. Notë mesatare e ponderuar, për studentët që ndjekin studimet në një program të ciklit të parë ose në një program të integruar të ciklit të dytë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, dhe që kanë kaluar në vitin pasardhës të studimeve sipas përcaktimeve në nenin 53 të Rregullores së UMT-së, **konsiderohet nota mesatare e ponderuar nga 5 deri 8.99, për provimet e marra me vlerësim pozitiv të vitit paraadhës.**
2. Për studentët që përfitojnë bursë dhe përjashtim nga tarifat e shkollimit, në llogaritjen e notës mesatare do të merren përcaktimet e VKM.nr.39, datë 23.01.2019 dhe VKM-së nr.40, datë 23.01.2019.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

**FLORIAN TOTI**



**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**ARBEN GJATA**